



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 12, Datë 20.01.2021

MBI

ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË Ë “SEMAN SUNPOWER” SH.P.K., PËR TRANSFERIM TË ASETEVE (VENDOSJE HIPOTEKE) NË FAVOR TË “INTESA SANPAOLO BANK” SH.A.

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, nenit 44, pika 1, të ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikat 1.3, dhe 1.6 të “Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; nenit 7 dhe nenit 11, pika 1, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.07.2016; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.01.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr.9/1prot., datë 14.01.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve në favor të bankës “Intesa Sanpapolo Bank” sh.a.,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 189, datë 19.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.
- Në vijim të sa më sipër, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1163/1 prot., datë 11.12.2020, duke i njoftuar fillimin e procedurës, dhe i kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj.
- Me shkresën nr. 3 prot., datë 14.01.2020, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, për arsye se ajo e ka pasur të pamundur të plotësojë më afat dokumentacionin e konstatuar të munguar për shkak të periudhës së pandemisë COVID-19, e cila ka shfaqur pengesa për të vazhduar me ndjekjen e procedurave pranë institucioneve për dokumentacionin e kërkuar, kohës së zgjatur e pushimeve në ndërrimin e viteve, si dhe vonesave

të shkaktuara për marrjen e dokumentacionit nga banka e cila ka financuar projektin, për ta paraqitur pranë ERE-s.

- Në nenin 10, pika 3 të *Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve të të licencuarve*, përcaktohet se në rastin e transferimit të asetëve nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet më të madh se 10 MW, apo nga centralet në sektorin e gazit me vlerë me te madhe se 2.000.000.000, leke afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni është 60 ditë sektorin e, ndaj për kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” shpk, Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 21.01.2021
- Në nenin 53, pika 3, të Kodit të procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë përcaktohet se:
Afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.
- Duke qenë se kërkesa e shoqërisë për zgjatje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është bërë e arsyetuar dhe përpara mbarimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s, vlerësojmë se kërkesa e saj duhet të pranohet dhe të zgjatjen e afatit të trajtimit final të praktikës me 30 ditë pune.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” shpk., për transferim të asetëve (vendosje hipoteke), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.